

VENDIM
Nr. 61, datë 2.11.2007

**PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR NDËRTIM, INSTALIM DHE SHFRYTËZIM TË
CENTRALEVE ELEKTRIKE ME ERË, SI DHE PRODHIMIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA KËTO CENTRALE “HERA” SHPK (PROJEKTI KAPPET)**

*(Ndryshuar me vendimin nr. 93, datë 6.8.2008; nr. 65, datë 22.9.2009; nr. 254, datë
21.12.2020)*

(i përditësuar)

Në zbatim të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” me ndryshimet përkatëse, neni 13, pika 1, si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 4.4.2007 “Për miratimin e rregullores për procedurat e licencimit”, neni 11, pika 1, neni 13, pikat 1 dhe 2, vendimit nr. 44, datë 24.7.2007 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, neni 15, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 2.11.2007, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga “HERA” sh.p.k. për marrje licence për aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centralit elektrik me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga këto centrale,

VENDOSI:

I. Dhënie e licencës shoqërisë “HERA” sh.p.k. në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike (Projekti KAPPET), me fuqi 150 MGW, duke plotësuar kushtet e mëposhtme:

1. Brenda një afati kohor *15 muaj*¹ të realizojë:

- Sigurimin e dokumenteve të pronësisë, duke realizuar kalimin nga premtim shitjeje në titull pronësie dhe realizimin e kontratave të huapërdorjes ose qiramarrjes, për të gjithë sipërfaqen e nevojshme për realizimin e projektit.

- Kryerjen e një studimi fisibiliteti, që kushtëzohet me instalimin e kullave vrojtuese për të eksperimentuar në kushtet reale dhe nxjerrjen e konkluzioneve definitive për projektin e zbatimit. Përcaktimi në këtë studim edhe i kostos së prodhimit të energjisë elektrike. Ky studim të paraqitet në ERE përpara fillimit të zbatimit të punimeve. Për këtë shoqëria duhet të sjellë grafikun e rishikuar të punimeve.

2. Shoqëria “HERA” sh.p.k. duhet të paraqesë pranë ERE-s, marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a.-në, përpara fillimit të ndërtimit të objektit, ku të jenë të specifikuara detyrimet e ndërsjella, që rrjedhin nga Kodi i Transmetimit.

3. Shoqëria “HERA” sh.p.k. do të respektojë detyrimet e shërbimit publik që do të

¹ Vendimi nr. 65, datë 22.9.2009 në pikën 1 shprehet;

1. Të shtyjë me 12 muaj, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, afatet e përcaktuara në pikën “1” dhe “4” të vendimit nr. 61, datë 2.11.2007 “Për dhënie e licencës për ndërtim, instalim dhe shfrytëzim të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga këto centrale HERA sh.p.k. (Projekti KAPPET)”, të ndryshuar me vendimin nr.93, datë 6.08.2008 “Për një ndryshim në vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 61, datë 2.11.2007 “Për dhënie e licencës për ndërtimin e centraleve elektrike me erë dhe prodhimin e energjisë elektrike”.

² Vendimi nr. 254, datë 21.12.2020 në pikën 1 shprehet;

“1. Shtyrjen me 30 ditë të vendimmarrjes mbi “Kërkesën e shoqërisë ‘HERA’ sh.p.k. për zgjatjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nr. 61, datë 2.11.2007, të ndryshuar”.”

rrjedhin në zbatim të nenit 25 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

4. Koha e zbatimit të gjithë projektit përfshirë dhe kolaudimin e veprës, duke iu referuar datës së lëshimit të licencës të jetë *42 muaj*.

II. Afati i vlefshmërisë së licencës të jetë 30 vjet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta